



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Komuna e Prishtinës  
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



## **SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT**

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrin 63.1.2. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "NTSH BEDI COM" të datës 22.07.2025 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizimi me Pelet per ngrohjen e objekteve arsimore, AMF-te, bashkesite lokale dhe nevojat tjera Komunale" me nr. të prokurimit 616-25-5512-1-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

### **V E N D I M**

- I. **MIRATOHET** si e bazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "NTSH BEDI COM" të datës 22.07.2025 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizimi me Pelet për ngrohjen e objekteve arsimore, AMF-te, bashkësítë lokale dhe nevojat tjera Komunale" me nr. të prokurimit 616-25-5512-1-1-1.
- II. **DETYROHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të publikoj Formularin për Korigjimin e Gabimeve përmes të cilit do të bëj korigjimin e kërkesave në dosjen e tenderit sipas të gjeturave të evidentuara në këtë vendim.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

### **Arsyetim**

Operatori ekonomik "NTSH BEDI COM" (tutje "parashtruesi") me datë 22.07.2025 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizimi me Pelet për ngrohjen e objekteve arsimore, AMF-te, bashkësítë lokale dhe nevojat tjera Komunale" me nr. të prokurimit 616-25-5512-1-1-1. Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistonjë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Faqe 1 nga 4

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:

"Kërkesa janë për rishqyrtim ngre shqetësimë lidhur me kriteret e përzgjedhjes të cilat e pengojnë konkurrencën e drejtë në mes të operatoreve ekonomik që e ushtrojnë këtë veprimitari. Rrjetimisht ne kërkojm nga AK KOMUNA E PRISHTINËS që të bëhen këto modifikime në kriteret e përzgjedhjes në vijim: Kërkesat mbi mundësitet tekniqe dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2, kërkesat në vijim: - Kërkesa Nr. 2. Te kete dy kamion me lift mbi 10 ton - Deshmuar me foto dhe Libreza valide. Ne rastet kur OE ka mareveshje per shfrytezimin e Kamionit me autovinç, OE duhet te dorezoj edhe marreveshjen per pajisen. OE N.T.SH. "BEDI COM" kërkon nga AK Komuna e Prishtinës që të hiqet ky kriter për arsyen e shtë joproportionale me qëllimin dhe natyrën e kontratës. Kërkesa për kapacitet mbi 10 ton për të dy kamionët me lift kufizon padrejtësisht konkurrencën dhe nuk merr parasysh faktin se shumë prej operacioneve të kërkua mund të përbushen me mjete me kapacitet më të vogël ose të kombinuar. Propozim: Kërkesa të riformulohet në mënyrë më fleksibile, duke lejuar përdorimin e kamionëve standard, sipas nevojës së përbushjes së kontratës apo edhe të hiqet si kriter nga dosja. - Kërkesa Nr. 4. një kamion me vinq deri ne 7 ton - Deshmuar me foto dhe Libreza valide. Ne rastet kur OE ka mareveshje per shfrytezimin e Kamionit me autovinç, OE duhet te dorezoj edhe marreveshjen per pajisen. OE N.T.SH. "BEDI COM" kërkon nga AK Komuna e Prishtinës që të hiqet ky kriter për arsyen e shtë joproportionale me qëllimin dhe natyrën e kontratës. Kërkesa për kamion me vinq deri ne 7 ton kufizon padrejtësisht konkurrencën, për arsyen së një lloj i tillë i kamioneve gjindet rrall në përdorim, ndërsa në anën tjeter kamion me vinq deri ne 7 ton nuk e shtë fare relevant për përbushjen e kontratës. Propozim: Kërkesa për kamion me vinq deri ne 7 ton të hiqet si kriter nga dosja. - Kërkesa Nr. 6. Kontrata dhe referenca ne tri vitet e fundit per lende djegese me vlerë 450,000.00 Euro - Një listë te kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 6 te Dosjes se Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje e furnizimeve.

OE N.T.SH. "BEDI COM" mendon se kjo kërkesë nuk e shtë përcaktuar në lidhje të drejtpërdrejt me objektin e kontratës, për arsyen se objekti e shtë furnizim me pelet dhe referencat duhet të kerkohen vetëm për pelet, jo për lëndë djegëse. "Kriteri për kontrata dhe referenca ne tri vitet e fundit per lende djegese e shtë shumë i përgjithësuar dhe lejon interpretim të gjerë, duke përfshirë edhe operatorë që nuk kanë përvojë me pelet si produkt specifik. Pra ky kriter krijon mundësi që përfurnizim me pelet të ofertojnë edhe OE që merren me furnizim me naftë, gaz apo produkte të tjera djegëse, duke i dëmtuar kështu OE që veprimitari kryesore e kanë prodhimin dhe furnizimin me pelet. Si e tillë kërkesa bie në kundërshtim me nenin 28.4 të LPP-së, pasi nuk lidhet drejtpërdrejt me objektin e kontratës dhe me nenin 59 të LPP-së duke krijuar paqartësi në dosjen e tenderit dhe vendos operatorët në pozitë të pabarabartë. Propozim: Meqënse në aktivitetin e prokurimit "Furnizimi me dru per ngrohjen e objekteve arsimore, AMF-te, bashkesit lokale dhe nevojat tjera Komunale" Komuna e Prishtinës ka specifikuar qartë që kontrata dhe referenca ne tri vitet e fundit të jenë per furnizim me dru, kërkojmë që ta bëjë të njëjtën gjë edhe për pelet. Pra, të modifikohet ky kriter dhe të kerkohet që OE të kenë kontrata dhe referenca ne tri vitet e fundit per furnizim me pelet. Modifikimi i këtij kriteri do të siguroj trajtimit të barabartë për OE që merren më prodhim dhe tregtim të peletit si dhe do ta siguroj AK që kontrata do të realizohet në mënyrë ekonomike, efikase dhe efektive. - Kërkesa Nr. 7. Certifikata e kualitetit ENplus, nga një institucion i pavarur dhe i certifikuar - te derzohet certifikata e kualitetit ENplus Në lidhje me kërkesën për dorëzimin e certifikatës së kualitetit ENplus, të lëshuar nga një institucion i pavarur dhe i certifikuar,

vlerësojmë se kjo kërkesë është kufizuese dhe përjashtuese në raport me realitetin e tregut vendor. Konkretisht, standardi ENplus është një sistem vullnetar certifikimi, jo detyrim ligjor. Kërkesa për ENplus cenon parimin e trajtimit të barabartë dhe konkurrencës, duke përjashtuar OE të cilët mund të ofrojnë produkte të të njëjtit kualitet apo më të lartë, por të certifikuar nga skema të tjera të njoitura ndërkombëtare. Propozim: Kërkesa certifikata e kualitetit ENplus, nga një institucion i pavarur dhe i certifikuar të hiqet si kriter. - Kërkesa Nr. 9. autorizimin e prodhuesit që garanton sasin dhe kualitetin e peletit, prodhuesi te jete i licencuar - Deshmi mbi kualitetin e peletit dhe kopjen e licences se prodhuesit. Kërkesa që OE të dorëzojë autorizimin e prodhuesit që garanton sasinë dhe cilësinë e peletit, si dhe që prodhuese të jetë i licencuar, është e kuptueshme në aspektin e sigurimit të cilësisë dhe origjinës së produktit, por në formën aktuale paraqet kufizime të panevojshme dhe të pajustifikuara. Së pari, në shumicën e vendeve të BE-së dhe rajonit, nuk ekziston një "licencë specifike për prodhim peleti", por kompanitë operojnë në bazë të regjistrimit të përgjithshëm të veprimitarës dhe certifikatave të standardeve të cilësisë (ISO, etj.). Prandaj, kërkesa për "licence të prodhuesit" është e paqartë dhe mund të shkaktojë përjashtim të OE-ve që merren me tregtinë e peletit dhe po ashtu I përjashton prodhuesit vendor të peletit. Së dyti, kërkesa për autorizim prodhues bie ndesh me parimin e lirive të tregtisë dhe bashkëpunimit ndërmjet operatorëve ekonomikë të certifikuar në zinxhirin e furnizimit. Propozim: Kërkesa autorizimin e prodhuesit që garanton sasin dhe kualitetin e peletit, prodhuesi te jete i licencuar, të hiqet si kriter nga dosja e tenderit".

Lidhur me pretendimet ankimore, është gjetur se pretendimi lidhur me 2 kamionët me lift mbi 10 tonë është e bazuar pasi që ekziston edhe kërkesa tjetër për kamionë me vinç deri në 7 tonë e cila është e mjafueshme për realizimin e kontratës. Rrjedhimisht pretendimi për largimin si kërkesë të DT pikën ku kerkohen 2 kamionë me lift mbi 10 ton është e bazuar ndërsa pretendimi kundër kërkesës me vinç deri në 7 tonë është e pabazuar dhe kjo kërkesës mbetet si e tillë në dosjen e tenderit. Tuttje sa i përket pretendimit për EN ISO certifikatën është e bazuar pasi që kjo certifikatë nuk është e domosdoshme përderisa ekziston kërkesa për licensën e prodhuesit. Prandaj kërkesa për largimin e certifikatës EN ISO largohet nga DT (pretendimi në këtë pikë është i bazuar) ndërsa pretendimi për licensën e prodhuesit është e pabazuar dhe ajo kërkesë mbetet si e tillë në DT. Po ashtu edhe kërkesa për referencat është e pabazuar pasi që referencat kerkohen të ngjashme dhe jo domosdoshmërisht duhet të janë identike.

Vlen të citohet nen 7 paragrafi 2 të LPP përmes të cilit përcaktohet se "Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik".

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi ka paraqitur argumente për të mbështetur pjesërisht pretendimet e tij ankimore. Prandaj kërkesa e tij për rishqyrtim është miratuar si e bazuar pjesërisht.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1.2. të RRPP. Për pikën III dhe pikën IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

#### Faqe 3 nga 4

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000

Tel.: 038-200-40-111

Email: [yasar.shehu@rks-gov.net](mailto:yasar.shehu@rks-gov.net)

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 28.07.2025

Visar SHEHU



Udhëheqës i Sektorkut të Prokurimit  
Komuna e Prishtinës

**Këshillë juridike:**

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.

Faqe 4 nga 4